



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranimar / Dorezuar Prilidjen / Protalato Received / Delivery	02.02.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinstvo Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPNDISTICK	500/2022		1/4



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.14/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca- anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit A.nr.1757/2020 të datës 24.12.2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrativ, ka shqyrtuar ankesën A.nr.230/2020 të datës 13.08.2020, të parashtruar nga ankuesi me adresë Prishtinë, kundër organit të punësimit Autoritetit Kombëtar i Kualifikimeve, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nenparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nenparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Rregullat dhe Procedurat e Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 02.02.2022, në mënyrë unanime mori këtë:

**V E N D I M**

**Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.230/2020 e datës 13.08.2020, e parashtruar nga ankuesi**

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, me datë 13.08.2020 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 1535/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me kërkesë për njohjes e së drejtës për kompensimin e shtesave për kuadrin deficitar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.08.2020, ka proceduar kërkesën me numër të protokollit 1601/2020 për përgjigje në ankesë tek Autoriteti Kombëtar për Kualifikime, ndërsa me datën 07.09.2020, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat e lëndës.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes shkresës me numër protokollit 1974/2020 të datës 05.10.2020, ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës numër A.nr.230/2020 të datës 13.08.2020, duke e udhëzuar të njëjtin për të drejtën e inicimit të padisë në gjykatën kompetent në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativë, me datë 24.12.2021 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.1757/2020, i pranuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 13.01.2022, me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të datës 05.10.2020 dhe obliguar të njëjtin që në afat prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit me numër protokollit 1970/2020 të datës 13.08.2020.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 1535/2020 të datës 13.08.2020 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Aktgjykimin A.nr.1757/20 të datës 24.12.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, Kërkesën me numër reference 882 të datës 22.06.2020 për miratimin e shtesës për IT drejtuar Drejtorit të DASHC-së, Aktin e Emërimit të datës 05.03.2020 për ankuesin, Vendimin me numër 02-106 të datës 05.03.2020 për njohjen e përvojës së punës së ankuesit, Certifikatën e datës 12.05.2014 lidhur me trajnimin e përfunduar CISCO: Routing and Switching Essentials, Certifikatën e datës 29.01.2014 lidhur me trajnimin e përfunduar Cicko: Introduction to Networks, Shkresën e Noterit Lrp.nr.357/2019 lidhur noterizimin e diplomës Nr.163/13 të datës 29.07.2013, Diplomën me numër 163/13 të datës 29.07.2013, të lëshuar nga Kolegji "Iliria", Vendimin NR.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Aneksin I lidhur me Listën dhe titujve të punonjësve që do të jenë përfitues të masave stimuluese duke e përfshirë edhe shumën për këto pozita, Konkursin e datës 11.09.2019 për pozitën "Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative dhe Logjistikë", Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 1601/2020 të datës 21.08.2020, Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 1702/2020 të datës 07.09.2020, Njoftimin e me numër të protokollit 1974/2020 të datës 05.10.2020, Emalin e ankuesit të datës 25.02.2021.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës respektivisht sipas Akt Emërimit të datës 05.03.2020, rezulton së ankuesi ka themeluar marrëdhënie të punës në Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve, në pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Teknologji Informative dhe Logjistikë". I njëjti me datë 23.06.2020, ka parashtruar kërkesë për miratim të shtesave të IT, pranë Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil (tutje referuar DASHC).

Ankuesi pas heshtjes administrative të DASHC-së, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me kërkesë për njohjen e së drejtës së kompensimit për shtesat për kuadrin deficitar, sipas Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civil si dhe Vendimit me numër 02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Kosovës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar Vendimin Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, përmes të cilit është aprovuar lista e pozitave dhe shtesave në pagë për kategori të veçanta të profesioneve deficitare në fushën e teknologjisë informativë dhe inxhinieringut, dhe Vendimin Nr.07/29 të datës 31.07.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar procedura për parashtrimin dhe trajtimin e kërkesave dhe mënyra e realizimit të shtesave për kategoritë e veçanta të profesioneve deficitare, dhe rrjedhimisht është konstatuar se aprovimi i shtesave në pagë për pozita deficitare është bërë me qëllim të ruajtjes së kategorive të veçanta deficitare të punonjësve, stimulimit të konkurrimit për profesione të veçanta deficitare dhe zbatimit të parimit të pagesës së njëjtë për punë të njëjtë në të gjitha organizatat buxhetore. Po ashtu, me këtë vendim është përcaktuar se paga bazë së bashku me shtesat mbi pagë nuk mund të tejkalojnë pagën e zyrtarëve të lartë të emëruar nga KELP-i, si dhe është obliguar Ministria përgjegjëse për Administratë Publike dhe Ministria e Financave për shqyrtimin e listës dhe standardëve kualifikuese dhe shumës stimuluese për postet e caktuara, së paku një herë në gjatë muaj.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 13.05.2010 ka aprovuar Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përmes të cilit është bërë përcaktimi i sistemit dhe strukturës së pagave, shtesave dhe kompensimeve të tjera për nëpunësit civilë, ndërsa me dispozitat e nenit 14 të këtij ligji është përcaktuar se: 1. Shtesat mbi pagën bazë janë: 1.1. shtesa për punë me ndërrime dhe jashtë orarit të punës; 1.2. shtesa për kushte specifike pune; dhe 1.3. shtesa për kushtet e tregut. Përkitazi me këtë, duke u bazuar në dispozitat e nenit 27 të Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, Qeveria e Republikës së Kosovës, me datë 24.12.2012 ka aprovuar Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përmes të cilës ka përcaktuar kushtet dhe procedurat për shtesat dhe kompensime të tjera mbi pagën bazë të nëpunësve civilë. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore janë shfuqizuar të gjitha aktet nënligjore të cilat kanë rregulluar shtesat dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil, dhe rrjedhimisht edhe Vendimi Nr.02/29 i datës 31.07.2008 dhe Vendimi Nr.02/39 i datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, konstatim ky i dhënë edhe në Raportin Vjetor të Vitit 2017 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kështu që mbi këtë bazë, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankuesit për realizimin e shtesës në pagë sipas Vendimit Nr.02/39 të datës 08.10.2008 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të Tjera të Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 8 të kësaj rregullore, ka konstatuar se Ministria përgjegjëse për administratë publike, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për financa, mund të kërkojë nga Qeveria që të miratojë një shtesë për kushtet e tregut për pozitat ose llojet e pozitave për të cilat niveli i pagës për personelin e ngjashëm nga organizatat dhe punëdhënësit e tjerë jashtë Shërbimit Civil është së paku 40% më i lartë sesa niveli i pagës që ofrohet nga Shërbimi Civil, e kjo shkakton vështirësi të konsiderueshme në rekrutimin dhe mbajtjen e personelit të kualifikuar për ato pozita ose lloje të pozitave në administratë publike, ndërsa institucioni për realizimin e shtesës për kushtet të veçanta të tregut duhet t'i ofrojë Ministrisë përgjegjëse për administratë publike kërkesën lidhur me arsyeshmërinë e realizimit të shtesës dhe një analizë që dëshmon vështirësitë të cilat janë hasur nga institucioni gjatë rekrutimit dhe mbajtjes së personit të kualifikuar, listën e pozitave përkatëse dhe koston vjetore të vlerësimit financiar.



Shtesa mbi pagën bazë për kushte të veçanta të tregut nuk mund të tejkalojë më shumë se 50% të pagës bazë.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.14/2022

**Rushit KAJTAZI**

Procesmbajtës

**Ardita Haxhnikaj-DEMI**

Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve;
- Udhëheqësit të Personelit të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

